



Tiranë, më 17 Prill 2018

### Terma Reference për Ekspertë

**Titulli i projektit:** “Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Integrimin e Komunitetit Rom”

**Koha e zbatimit të projektit:** 01 Shkurt 2018 – 31 Korrik 2020

**Koha e angazhimit:** Maj 2018 – Dhjetor 2018

**Donatori:** Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri

### Informacion për organizatën

Unioni për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri “ Amaro-Drom” është krijuar në vitin 1996 dhe gëzon statusin e organizatës jo qeveritare, jo politike, jo fitimprurëse. Misioni i organizatës përqendrohet në katër shtylla si më poshtë vijon:

- Mbrojtja e identitetit dhe të drejtave të komunitetit Rom.
- Rritja e nivelit të edukimit dhe arsimimit në komunitetin Rom.
- Përmirësimi i kushteve socio-ekonomike.
- Integrimi i komunitetit kryesisht gjenerata e re në shoqërinë maxhoritare.

### Përshkrim i projektit

Projekti “Fuqizimi i Organizatave të Shoqërisë Civile për Integrimin e Komunitetit Rom” financohet nga Delegacioni i Bashkimit European në Shqipëri dhe zbatohet nga Qendra Kombëtare Burimore e Trajnimit dhe Asistencës Teknike –ANTTARC, në partneritet me Fondacionin “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i mosmarrëveshjeve –AFCR dhe Unioni për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Rom në Shqipëri “Amaro-Drom”.

Qëllimi i projektit është që të kontribuojë në zbatimin e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane përmes advokimit për qeverisje të mirë dhe llogaridhënies nga institucionet publike përgjegjëse.

## **Qëllimi i angazhimit të ekspertit**

Me qëllim rritjen e kapacitetit të stafit të organizatave të Shoqërisë Civile Rome dhe Egjiptiane të cilat janë aktive në ofrimin asistencës për shërbimet ligjore dhe sociale, Unioni Amaro-Drom fton persona të interesuar të aplikojnë për t'u përfshirë si ekspertë në aktivitetet e mëposhtme:

- Përgatitjen e modulit të trajnimit në ofrimin e shërbimeve ligjore dhe sociale;
- Trajnim në fushën e ofrimit të shërbimeve ligjore dhe sociale.

Moduli i trajnimit duhet të përmbajë çështjet si më poshtë vijon:

- Regjistrimi civil dhe aksesimi në drejtësi
- Ndhurma juridike dhe procedura për të përfituar atë
- Arsimimi
- Punësimi, Arsimi Profesional dhe Trajnimi
- Kujdesit shëndetësor
- Strehimi.

## **Detyrat dhe përgjegjësitë e ekspertit**

- Të përgatisë modulën e trajnimit;
- Të koordinojë me Unionin Amaro-Drom për përgatitjen e modulit dhe programit të trajnimit;
- Të dorëzojë modulën në afatin e përcaktuar;
- Të prezantojë modulën përkatës në aktivitet.

## **Përgjegjësitë e Unionit “Amaro-Drom”**

- Të koordinojë me grupin e ekspertëve për përgatitjen e programit të aktivitetit;
- Të verë në dispozicion të ekspertëve materiale dhe informacione të nevojshme;
- Të paguajë ekspertin bazuar në kushtet e përcaktuara në kontratë.

## **Kriteret që duhet të plotësohen nga të interesuarit:**

- Diplomë universitare;
- Minimalisht 5 vjet experiencë në dhënien e trajnimeve dhe në lidhje me temën e përzgjedhur të trajnimit;
- Përvojë në lidhje me shoqërinë civile;
- Aftësi të mira komunikuese, organizative dhe analizuese;
- Aftësi të mira në shkrimin e raporteve

## **Dorëzimi i aplikimeve**

Aplikantët e interesuar janë të lutur të dërgojnë një letër të shkurtër shprehje interesi dhe një CV në adresën e e-mailit: [amarodrom@abissnet.al](mailto:amarodrom@abissnet.al) ose me postë në adresën:

*Unioni për Zhvillimin dhe Integrimin e Minoritetit Romë në Shqipëri Amaro-Drom  
Rruga: Sulejman Pasha, Lagjia.4, pallati.2, shk.3 Tiranë-Shqipëri*

## **Afati i dorëzimit**

Aplikimi duhet të dorëzohet brenda datës 27 Prill 2018.

**Shënim:** Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të njoftohen.

